



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RRGGK REAGON KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) përkrah reagimin dhe kërkesat e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës lidhur me gjuhën denigruese, poshtëruese, fyese dhe të pamoralshme, e cila është përdorur nga hoxhë Irfan Salihu, imam në xhaminë Suzi Zerrini të Prizrenit, ndaj grave të Kosovës.

RrGGK gjithashtu e sheh këtë deklaratë të hoxhë Salihut si cenim të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila thotë: “Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit.”

RrGGK vlerëson se gjuha e përdorur në deklaratën e hoxhë Salihut bie në kundërshtim me Nenin 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku thuhet se “Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare”, duke nxitur në këtë mënyrë përçarje fetare dhe urrejtje në mes të popullit të Kosovës.

Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Çdo lloj thirrje e tillë është antikushtetuese, prandaj ne kërkojmë nga qeveria që të hetojë kush qëndron mbrapa këtyre zërave që çënojnë liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ne presim që jo vetëm gratë, por edhe burrat në Parlament të reagojnë zëshëm kundër këtyre zërave të urrejtjes dhe diskriminimit.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000
Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org